



Prishtinë: 28.03.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1128_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_1903_02_19**.

në seancën e mbajtur më datë 28.03.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** ankesa e konsumatorit N.B, nga Fshati Studenqan, Suharekë si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi
- II. **OBIGOHET** KESCO që konsumatorit me shifër DPZ – 9033269 t'i anulojë korrigjimin plotësues nr. 44410DPZ-9033269 të datës 08.12.2014 në vlerë prej 8,734.86€.

A r s y e t i m

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji konsumatori të përfaqësuar nga N. B. me shifër DPZ - 9033269 ka parashtruar ankesë me të cilën duke kundërshtuar përgjigjën e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar ti shqyrtohet korrigjimi plotësues nr.44410DPZ-9033269 të datës 08.12.2014.

Bordi i ZRRE-së, me qëllimit të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike e cila është iniciuar nga palët në kontest lidhur me pikën matëse të theksuar më lartë ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha dëshmitë e mbledhura për veprimet e ndërmarra nga palët në kontest lidhur me këtë pikë matëse.

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar në ZRRE me datë 08.06.2015 ka apeluar përgjigjen e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 16.03.2015 lidhur me kontestimin e korrigjimit plotësues nr.44410DPZ-9033269 të datës 08.12.2014, për shkak të matjes jo të saktë të njehsorit elektrik.

Me datë 24.11.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr.3575516 prej TL=2531 kWh dhe TU=358 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar se në momentin e inspektimit display-i i njehsorit elektrik nuk tregon të dhëna, kurse tërheqja e energjisë nëpër faza është L1-452 A, L2-441 A dhe L3-445 A. Po ashtu ekipi i KEDS-it ka bërë zhvendosjen e njehsorit elektrik në orman të mbyllur, si dhe kanë evidentuar që pas ndërhyrjes së tyre në njehsorin elektrik prapë janë kthyer vlerat.

Provë: Procesverbali i inspektimit nr. 1241282 i datës 24.11.2014

Departamenti i faturimit në KEDS me datë 08.12.2014 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjim plotësues nr.44410DPZ-9033269 të datës 08.12.2014 në vlerë financiare **8,734.86€** duke bërë



korrigjimin plotësues për faturat e periudhës 12/2013 deri në periudhën 11/2014.
Korrigjimi plotësues 44410DPZ-9033269 i datës 08.12.2014

Provë:

Me datë 09.01.2015 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar korrigjimin plotësues 44410DPZ-9033269 datë 08.12.2014.

Provë: Ankesa e konsumatorit e datës 09.01.2015

Me datë 16.03.2015 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe procesverbalit të inspektimit nr. 1241282 të datës 24.11.2014.

Provë: Përgjigja e KESCO-s e datës 16.03.2015

Me datë 08.06.2015 konsumatori ka parashtruar ankesë në ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar ti shqyrtohet korrigjimi plotësues 44410DPZ-9033269 datë 08.12.2014.

Provë: Ankesa e konsumatorit në ZRRE-së datë 08.06.2015

Bordi i ZRRE pas analizave të të gjitha dëshmimeve të paraqitura nga konsumatori dhe KESCO/KEDS, ka vërejtur se:

Punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse me datë 24.11.2014 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr.3575516 prej TL=2531 kWh dhe TU=358 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar se në momentin e inspektimit display-i i njehsorit elektrik nuk tregon të dhëna, kurse tërheqja e energjisë nëpër faza është L1-452 A, L2-441 A dhe L3-445 A. Po ashtu ekipi i KEDS-it ka bërë zhvendosjen e njehsorit elektrik në orman të mbyllur, si dhe kanë evidentuar që pas ndërhyrjes së tyre në njehsorin elektrik prapë janë kthyer vlerat. ZRRE ka shqyrtuar me kujdes procesverbalin e inspektimit dhe konstaton se ekipi i KEDS-it nuk ka evidentuar në procesverbal se cilat janë ndërhyrjet të cilat i ka bërë në njehsorin elektrik nr.3575516 e q kanë ndikuar në mos paraqitjen e vlerave të shpenzimeve në njehsorin elektrik, si dhe në bazë të evidentimeve vërtetohet po ashtu se njehsori elektrik ka qenë i vulosur dhe se në asnjë formë nuk ka qenë i dëmtuar.

Provë: Procesverbalin e inspektimit nr. 1241282 i datës 24.11.2014

Bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka luhatur në shpenzim të energjisë elektrike. ZRRE ka bërë analizën e rrjedhës së energjisë elektrike me tre njehsorët elektrik nr.96256873, nr.9783027 dhe nr.35755161 dhe konstaton se ka rritje graduale nga viti në vit. Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike për periudhat kontestuese me njehsorin elektrik nr.35755161 dhe njehsorët elektrik nr.96256873, dhe nr.9783027 për periudha të njëjta kohore, Bordi i ZRRE konstaton se ka luhatur dhe ndryshim të shpenzimeve të energjisë elektrike. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr. 96256873 për periudhën 06/2011 deri në periudhën 03/2012 është 6429.72 kWh/muaj, me njehsorin elektrik nr.9783027 periudha 06/2012 deri në periudhën 03/2013 është 17,217.24 kWh/muaj, kurse me njehsorin elektrik nr. 35755161 i cili është vendosur për matje në periudhën 05/2013 mesatarja e shpenzimeve për periudhën 06/2015 deri në periudhën 03/2016 është 26,537.76 kWh/muaj, periudhën 06/2016 deri në periudhën 03/2017 është 30,120.72 kWh/muaj, si dhe periudhën 06/2017 deri në periudhën 03/2018 është 36,108.84 kWh/muaj.

Provë: Rrjedha e energjisë elektrike

Departamenti i faturimit në KEDS me datë 08.12.2014 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjim plotësues nr.44410DPZ-9033269 të datës 08.12.2014 në vlerë financiare 8,734.86€ duke bërë korrigjimin plotësues për faturat e periudhës 12/2013 deri në periudhën 11/2014. Ky korrigjim plotësues është bërë duke ri faturuar faturat e asaj periudhe për shkak të mos matjes së saktë të njehsorit elektrik nr.35755161 përkatësisht bazuar në procesverbalin e KEDS-it nr.1241282, por që ka



përrjashtuar faturën e periudhës mars 2014. ZRRE ka shqyrtuar korrëgjimën e bërë nga KEDS dhe konstaton se ky korrëgjim është bërë duke marr për bazë faktori korrëgjues $K=1.9433$, përkatësisht $Y=0.9433$, si rrjedhojë e periudave në rregull dhe jo në rregull. ZRRE konstaton se ky korrëgjim është i pakuptimtë duke marr për bazë se nga rritja (korrëgjimi) e faturimit është përjashtuar fatura e periudhës mars 2014 kurse të gjitha faturat e tjera janë korrëgjuar për faktorin $K=1.9433$ edhe përkundër faktit që faturat e me hershme me njehsorin elektrik nr.35755161, si dhe të me vonshme kanë pasur pothuajse vlera të njëjta me faturat e njëjta të periudhave me të hershme.

Provë: Korrëgjimi plotësues 44410DPZ-9033269 datë 08.12.2014

Bazuar në kodin e matjes përkatësisht nenin 3.9.4 dhe 3.9.5 (Testimi i njehsorëve me pajisje portabël), si dhe nenin 4.3.2 përcaktohen qartë detyrimet e OSSH-së lidhur me inspektimin dhe testimin e njehsorëve brenda periudhave të caktuara kohore, si dhe përgjegjësinë mbi operimin dhe mirëmbajtjen e njehsorëve elektrik. Në nenin 3.9.4 thuhet se: Njehsorët indirekt multifunksional të cilët kyçen përmes TMRR dhe TMT duhet që së paku 1 (një) herë në vit ose kur të merret ankesa, cilado kohë që është më e shkurtër të testohen”, kurse në nenin 3.9.5 thuhet se: “Testimi i përbashkët në prezencë të përfaqësuesit të konsumatorit kurdo që është e mundur posaçërisht TMRR, TMT, Njehsorët e kërkesës maksimale (të ashtuquajturit GM multifunksional) duhet të bëhet në bazë vjetore, ose në çdo gjashtë muaj varësisht nga rasti që paraqitet, kurse në nenin 4.3.2 thuhet se:” Operimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të njehsorit përfshinë instalimin e bërë në bazë të standardeve të kërkuara, mirëmbajtjen e rregullt, kontrollimin e TMRR, TMT, dhe njehsorëve tjerë, instalimin e përcuesve, terminalët, shtrirjen e mirëfilltë të kabllave, mbrojtjen, pastrimin dhe gjendjen e lidhjeve të kutive të njehsorëve, gjendjen e pllombave, leximin ditor të rregullt të njehsorëve si dhe nxjerrjen e të dhënave nga pajisja për lexim, nga Qendra Grumbulluese e të Dhënave si dhe kushtimit të vëmendjes për ndonjë prishje eventuale të sistemit të njehsorëve matës. **Provë:** Kodi i matjes për OSSH

ZRRE ka kërkuar nga KESCO që të ofroj listat e leximit për periudhën 05/2014 deri në periudhën 02/2015, por që KESCO ka dështuar të ofroj ato. ZRRE konstaton se përmes listave të leximeve apo procesverbaleve të leximit ka mundur që të përcaktohet saktë periudha e defektit të njehsorit elektrik nga ekipet e KEDS-it me çka edhe do të vërtetoheshin pretendimet e KEDS-it që njehsori elektrik nuk ka bërë matje të saktë. Lidhur me këtë, Bordi i ZRRE konstaton se KEDS nuk ka arritur të argumentojë dhe ta bazojë korrëgjimën shtesë nr.44410DPZ-9033269 të datës 08.12.2014 në vlerë prej **8,734.86€**, andaj edhe ky korrëgjim shtesë duhet të shkarkohet.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit: N. B.
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.